

Pierre de Coubertin

Njeriu i sportit



Pater Didon (1840-1900)

Ai vuri në jetë idetë e Coubertin në «Kolegjin» e tij në Paris. Themeluesi i motos: <<Citius - Altius - Fortius>> (më shpejt-më lartë-më fortë.)

I deprimuar nga humbja e Francës në luftën e viteve 1870-71 Coubertin e argumentoi këtë disfatë si „dobësi fizike të popullsisë franceze“. Ai vetë refuzoi karrierën ushtarake dhe zbuloi sportin si „burimin e përmirësimit të brendshëm dhe për forcimin e rinisë...“

Përpyekje të rëndësishme të Coubertin për të futur sportin në shoqëri ishin:

- Përpyekja për të futur sportin në shkollë,
- Zhvillimi i një „Gjimnastike të dobishme“,
- realizimi i motos: „Sport për të gjithë“
- Themelimi i shoqatave dhe organizatave të ndryshme sportive
- Botimi i artikujve të shumta mbi pedagogjinë e sportit

„Mundësi për të gjithë për t'u marrë me sport ...“

Coubertin hartoi një koncept të ri social mbi sportin: sporti përmbush një detyrë sociale dhe morale, stërvitja sportive është një përgatitje për jetën shoqërore dhe morale. Pierre de Coubertin shkruante:

„Kohë më parë sporti ishte thjesht një mundësi për të kaluar kohën sidomos për rininë e pasur. Une kam punuar tridhjetë vjet që t'a kthej sportin në një kënaqësi të qytetarisë. Tashmë është e domosdoshme që kjo kënaqësi të depërtojë edhe në rininë e klasës punëtore.“
(Lettres Olympiques – Gazette de Lausanne 13.08.1919)

„Gjimnastika e dobishme“

I inspiruar nga zhvillimet e reja industriale dhe mënyra e re e të menduarit praktik Coubertin përpiqej të përshtaste ushtrime të ndryshme në mënyrë krejt të natyrshme në jetën njerëzore. Kriteret më të rëndësishme ishin:

- Motivacioni i mjaftueshëm
- shpenzime të pakta
- përvetësim i lehtë
- aftësia për t'i përdorur për një kohë të gjatë njohuritë e përfituara.

„Një skuadër në çdo komunë - një sallë stërvitjeje dhe shesh për të luajtur në çdo vend - një pishinë në çdo qytet-hipizëm dhe box, sa herë që të jetë e mundur - një kor në çdo skuadër sportive-sa më pak rregulla të hierarkisë - pa politikë, pa parti, pa një udhëheqës të huaj në sport“



1892-Lojë futboll në skuadra. Risi që nuk u perkrash.

Akuarel i babait të Coubertin, Charles, i cili paraqet lindjen e praktikës sportive: Futboll në Bois de Boulogne

„Sporti nuk është luks“

„Sporti nuk është luks. Për çdo njeri ai është burim i perfeksionimit të brendshëm. Është trashëgimi e njerëzimit dhe asgjë nuk e zëvendëson mungesën e tij.“

Pierre de Coubertin ishte i pari në botë që krijoi një teori mbi sportin dhe që e cilësoi atë të vlefshëm për edukimin. Për këtë ai meriton titullin e nderit.